## Fusha 2 : Arritjet e nxënësve

1. **Arritjet e nxënësve**
2. **Mbajtja/shpërndarja e nxënësve**
3. **Përsëritja e nxënësve**

| **1. Arritjet e nxënësve** | |
|---|---|
| **Temat** | Përdorimi i programeve mësimore, seminaret e ndryshme si dhe zbatimi i metodave dhe teknikave të reja në procesin edukativo-arsimor, ndikojnë në përmirësimin e arritjeve të nxënësve . |

| | |
|---|---|
| **● Ndjekja dhe arritja e nxënësve të gjinive, përkatsisë etnike sipas lëndëve mësimore, sipas periudhave kualifikuese dhe gjuhës mësimore**<br><br>**● Identifikimi i nxënësve që kanë vështirësi në mësim, nxënësve me talent të veçantë dhe atyre me nevoja të veçanta mësimore**<br><br>**● Përmirësimi i arritjes së nxënësve përmes mësimit plotësues** | Në shkollën, tonë nga ana e drejtorit dhe sherbimit profesional të shkollës, arsimtarëve iu janë dhënë udhëzime, konsultime profesionale me qëllim të organizimit sa më të mirë të procesit mësimorë dhe arritjes së rezultateve më të mira të nxënësve. |
| | Gjatë regjistrimit në klasë të parë nga ana e shërbimit pedagogjik me anë të testeve bëhet indetifikimi i nxënësve me vështirësi në mësim, nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe nxënësve të talentuar .<br><br>Me anë të mësimit plotësues ne si shkollë mundohemi të ndikojmë në përmirësimin e suksesit të nxënësve që hasin vështirësi në mësim edhe pse çdo herë e cekim se shkolla jonë ka nevojë për defektolog.<br><br>Për nxënësit<br><br>Në fund të vitit shkollorë 2022/23 nota mesatare prej klasës I-IX është 3.99 kurse në fund të gjysmevjetorit te parë ka qenë 3.46<br><br>-Në fund të vitit shkollorë 2023/24 nota mesatare prej klasës I-IX është 3.91 kurse në fund të gjysmevjetorit te parë ka qenë 3.33 |

| | |
|---|---|
| - **Kyçje e njejtë e nxënësve (pa dallim gjinie , moshe, nevojave të veçanta arsimore) në të ariturat gjatë realizimit të programit ekologjik** | Shkolla i respekton principet pa njëanshmëri gjatë kyçjes së nxënësve në të ariturat gjatë realizimit të programës ekologjike në pajtueshmëri me strukturën e shkollë pa dallim gjinie, moshe,dhe nevojave të veçanta arsimore. |

**Burimet e të dhënave :**

Programet dhe raportet shkollore, raportet nga shërbimet profesionale, analizat e suksesit, proçesverbalet nga organet profesionale të shkollës, etj..

| **2.Mbajtja/ shpërndarja e nxënësve** | |
|---|---|
| **Temat** | |

| | |
|---|---|
| • **Përfshierja e nxënësve**<br><br>• **Rregullshmëria në mësim**<br><br>• **Shpërndarja e nxënësve**<br><br>• **Kalimi i nxënësve prej një shkolle në një tjetër**<br><br>• **Përsëritja e vitit** | Numri i përgjithshëm i nxënësve në shkollën tonë gjatë vitit shkollorë 2022/2023 është 451 prej të cilëve 228 femra dhe 2023 meshkuj kurse për vitin shkollorë 2023/2024 ishte 455 prej të cilëve 2025 meshkuj kurse 230 femra.<br><br>Numri i nxënësve për vitin shkollorë 2023/2024 është për 4 më i madh se ai i vitit shkollorë 2022/2023 .<br><br>Shkolla grumbullon të dhëna për mungesat e nxënësve dhe kontribuon në rritjen e rregullshmërisë.<br><br>Numri më i madh i mungesave në fund të vitit shkollorë 2022/2023 është te klasa e nënta edhe ate: githsejt 139 prej të cilave 112 të arsyeshme dhe 27 të pa arsyeshme.<br><br>Në vitin shkollor 2023/24 kemi gjithesejt 3426 edhe atë 2576 me arsye dhe 850 pa narsye<br><br>Shkolla respekton procedurën për kalimin e e nxënësve nga një shkollë në një tjetër,por në shkollën tonë gjatë vitieve shkollore 2022/2023 dhe 2023/24 ka pasur e nxënës që janë transferuar prej shkolles tone në tjetër dhe anasjellats.<br><br>Përqindja e nxënësve të cilët kalojnë vitin është 100 % . Ne si shkollë në kohë marim masat e duhura për zvogëlimin e numrit të nxënësve të cilët mund të përsërisin vitin.<br><br>Gjatë vitit shkollorë 2022/2023 dhe 2023/24 në shkollën tonë nuk ka humbur vitin asnje nxenes. |

**Burimet e të dhënave**

Programi për punë të shkollës, raportet shkollore, listat e nxënësve, analiza e përfshirjes dhe mungesës nga mësimi,bisedat me drejtorin dhe organet profesionale, ditaret e klasave,qasja në evidencën dhe dokumentacionin pedagogjik,etj..

**Burimet e të dhënave**

Analizat për suksesin e nxënësve gjatë dy viteve të kaluara, qasja në dokumentacionin pedagogjik,bisedat me nxënësit,prindërit dhe me shërbimet profesionale etj..

| | | |
|---|---|---|
| | | Anketa eshte realizuar te nxenesit e klasave te larta<br><br>Gjithsejt të anketuar ishin 20 nxënës te klases se tretë.<br>Pyetjet për nxënësit<br>**1.A ndjehesh i sigurt në shkollë?**<br>90% ose 18 nxënës janë deklaruar pozitivisht<br>10% ose 2 nxënës janë deklaruar negativisht<br><br>**2.Cila formë mësimore ju pëlqen më shumë ?**<br>25% ose 5 nxënës kanë deklaruar se forma<br>frontale ju pëlqen më shumë<br>10 nxënës<br>kanë deklaruar se forma grupore ju pëlqen më shumë<br>50% , 5 nxënës<br>kanë deklaruar se forma<br>në çifte 25% ose |

| | | |
|---|---|---|
| **Anketuesi** | Pedagogu :<br><br>Bejtulla Idrizi | **3.A fitoni dhurata nga shkolla për suksesin e arritur?**<br><br>55% ose 11nxënës janë  deklaruar pozitivisht<br><br>45% ose 9 nxënës janë  deklaruar negativisht<br><br>**4. a ju duken interesante orët mësimore?**<br><br>80% ose 12 nxënës janë  deklaruar pozitivisht<br><br>20% ose 8 nxënës janë  deklaruar negativisht |

| | | |
|---|---|---|
| **Anketa me**<br><br>**prindërit** | | Gjithsejt të anketuar ishin 20 prindër<br><br>**Pyetjet për prindërit**<br><br>**1.A janë korrekt arsimtarët ndaj fëmijëve tuaj?**<br><br>90% ose 18 prindër janë deklaruar pozitivisht<br><br>10% ose 2 prindër janë deklaruar negativisht<br><br>**2.A jeni të kënaqur nga Këshillet prindore?**<br><br>90% ose 18 prindër janë deklaruar pozitivisht<br><br>10% ose 2 prindër janë deklaruar negativisht |

| | | |
|---|---|---|
| | | **3.A takoheni shpesh me kujdestarin e klasës?**<br><br>90% ose 18 prindër janë deklaruar pozitivisht<br><br>10% ose 2 prindër janë deklaruar negativisht<br><br>**4.A informoheni për suksesin e fëmijëve tuaj?**<br><br>90 % ose 17 prindër janë deklaruar pozitivisht<br><br>10% ose 3 prindër janë deklaruar negativisht |

**Përparësitë**

- Shkolla rregullisht ndjek arritjet e nxënësve të gjinive të ndryshme
- Rreullshmëria, disiplina e arsimtarëve dhe e nxënësve është e kënaqshme dhe në nivel të duhur
- Shkolla identifikon nxënësit që kanë vështirsi në mësim dhe nxënësit me talent të veçantë.
- Përmirëson aritjet e nxënësve përmes mësimit të rregullt dhe plotësues.
- Arsimtarët kanë njohuri për punën me kompjuter dhe atë e zbatojnë në mësimin e rregullt për realizimin e plan-programeve.

**Dobësitë**

- Shkolla ka nevojë për ndihmë profesionale si p.sh., defektolog) për realizimin e procesit edukativo-arsimor per femij me nevoja te veçanta
- Mungesa e mjeteve mësimore dhe përmirësimi i inventarit shkollorë

**Analizat e rezultateve**

Sipas analizave nga dokumentat e kontrolluara shihet qartë se arritjet e nxënësve janë në nivel të duhur. Në dokumentat pedagogjike mund të shohim se shkolla ka të dhëna për arritjen e nxënësve dhe rregullshmërinë e tyre në mësim si dhe i analizon shkaqet për mungesën e nxënësve në mësim. Nga pedagogu i shkollës dhe arsimtarët që janë udhëheqës të paraleleve rregullisht bëhen analiza për arritjen e nxënësve sipas lëndëve mësimore.

Duke u mbështetur në ditarët e paraleleve në shkollë, shohim se mësimdhënësit realizojnë mësim plotësues nga të gjitha lëndët mësimore për të cilat nxënësit kanë vështirësi dhe për nxënësit që tregojnë arritje më të mëdha.

Nga anketat e realizuara mund të konstatojmë se ekziston bashkëpunimi i arsimtarëve me prindërit dhe dhe prindërit informohen për suksesin e nxënësve.Gjithashtu nga anketat kuptojmë se nxënësit janë të kënaqur me realizimin e procesit edukativo-arsimorë në shkollë dhe nga siguria në shkollë si dhe më tepër e pëlqejnë formën mësimore në grupe.

**Aktivitet që në të ardhmen do të kyqen në planin zhvillimor**

- Shkolla do të bëjë kërkesë deri në qeverisjen komunale për organizimin e punës për nxënës me aftësi të kufizuara.
- Ndihmë profesionale si p.sh. logoped, defektolog për reaalizimin e procesit edukativo-arsimor
- Mungesa e sallës sportive dhe mjeteve sportive
- Mungesa e mjeteve mësimore dhe përmirësimi i inventarit shkollorë